

1. Thirrje për projekte ndërkombëtare AUF Covid 19.2



Në kuadër të aktiviteteve të saj lidhur me Covid-in AUF ka hapur që nga 5 Maji 2020, një thirrje për projekte ndërkombëtare në mënyrë që të ndihmojë brenda institucioneve anëtare, iniciativat studentore, të studentëve të inxhinierisë dhe punonjësve kërkimorë të rinj lidhur me pandeminë

Një shumë prej 1 milion eurosh është vënë në dispozicion për të financuar 92 projekte nga 87 institucione anëtare në 44 vende.

AUF e vëmendshme dhe e ndjeshme ndaj evolucionit të situatës së krijuar nga pandemia, bën thirrje për një projekt të ri ndërkombëtar "AUF-COVID-19.2" duke zgjeruar tipologjinë e projekteve të pranueshme. Thirrja është e hapur deri në 15 Korrik 2021.

Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[International call for projects AUF COVID-19.2 - AUF](#)

2. Programi i Mobilimit Jug-Jug: Studentët e doktoraturës dhe studentët post-doktoraturës në shkencat e mjedisit



AUF hap thirrjen për aplikime si pjesë e programit të ri doktoralë dhe post-doktoralë të mobilitetit Jug-Jug. Ky system lejon studentë doktoralë dhe post-doktoralë të përfitojnë një mbështetje financiare për një program kërkimor shkëmbim nga 2- 3 muaj në një fushë të lidhur me mbrojtjen mjedisore. Programi synon përfshirjen e kërkuesve nga një vend në zhvillim të atashuar në një institucion anëtar të AUF-së që dëshiron të kryejë punën kërkimore në një tjetër vend në zhvillim Thirrja është e hapur deri në 15 korrik 2021.

Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[South-South Mobility Program: PhD students and post-doctoral fellows in environmental sciences - AUF](#)

3. AUF nis një skemë etiketimi për organizimet në kuadër të 60 vjetorit të saj



Me rastin e 60 vjetorit të saj, i cili do të festohet në shtator të vitit 2021 në mbarë botën, AUF po nis një sistem etiketimi të organizimeve që vijnë nga sfera akademike, institucionale dhe qeveritare si dhe ato të organizuara nga shoqëria civile që do të organizohen nga 1 deri më 24 shtator 2021. Organizimet në kuadër të këtij aktiviteti do të vlerësohen në mediat e ndryshme të komunikimit të AUF dhe do të paraqiten në formën e një harte. Kjo thirrje është e hapur deri më 30 korrik 2021. Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[THE AUF LAUNCHES A LABELING SCHEME FOR ITS 60TH ANNIVERSARY - AUF](#)

4. Takimi i Parë Shkencor i Frankofonisë: Thirrje për punime



AUF hap thirrjen për punime si pjesë e Takimit të parë Shkencor të Frankofonisë që do të mbahet në 22 dhe 23 shtator 2021 gjatë Asamblesë së saj të 18-të të Përgjithshme. Kjo thirrje fton mësuesit, studiuesit, specialistët apo ekspertët të ndajnë përvojat e tyre dhe të vijnë me propozime konkrete dhe inovative në temën që kanë zgjedhur. Thirrja është e hapur deri më 30 qershor 2021.

Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[Premières Assises de la Francophonie Scientifique : Appel à communications - AUF](#)

5. Thirrje për aplikime: Edicioni i 5-të i Çmimit El Fassi



AUF çel edicionin e 5-të çmimit El Fassi. Ky çmim, jepet çdo katër vjet dhe është kulminacioni i punës së një personaliteti të shquar nga rrethet frankofonisë, veprimi i të cilit ka ushtruar një ndikim të gjerë nëpërmjet cilësisë së ekspertizës së tij dhe natyrës inovatore të veprimit të tij në nivel ndërkombëtar. Fituesi i çmimit El Fassi do të marrë një shpërblim prej 15,000 euro që do t'i jepet atij ose asaj me rastin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të AUF-së në Bukuresht nga 21 në 24 shtator 2021.

Thirrja për aplikime është e hapur deri më 25 korrik 2021. Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[Call for applications: 5th edition of the El Fassi Prize - AUF](#)

6. Konkursi Ndërkombëtar i Sipërmarrjes studentore: 60 sekonda për të bindur



Me rastin e 60 vjetorit të saj, AUF organizon, në partneritet me TV5MONDE, France Médias Monde (RFI, France 24, Monte Carlo Doualiya) dhe L'Orient-Le Jour, një konkurs për të promovuar frymën e sipërmarrjes mes të rinjve: "60 sekonda për të bindur: garë ndërkombëtare e sipërmarrjes studentore". Konkurrimi është i hapur për studentët nga institucionet anëtare të AUF-së në gjithë botën. Paraqitja e projektit bëhet për 60 sekonda krono në formatin video. Në fund të ditës, katër çmime me vlerë nga 1500 euro në 300 euro dhe bën të mundur lidhjen e fituesit me mentorët dhe inkubatorët. Thirrja për aplikime është e hapur deri më 26 qershor 2021. Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[International Student Entrepreneurship Competition: 60 seconds to convince - AUF](#)

7. Thirrje për aplikime, edicioni i 2-të: Etiketa franko-franko- e inovacionit të përgjegjshëm



Programi i AUF-së për veprim (Action pour l'Innovation responsable francophone) me 8 partnerët e saj, Réseau de Recherche sur l'Innovation (RRI), Institut de Recherche pour le Développement (IRD), Afric'Innov, SoScience, Agence Française pour le Développement (AFD), Ministère de l'Europe et des Affaires Etrangères (MEAE), B&L évolution, Institut Français, ka hapur thirrjen e dytë ndërkombëtare për aplikime për etiketën e gjuhës frënge të inovacionit të përgjegjshëm që synon të identifikojë , të vlerësojë dhe të zhvillojë iniciativa të përgjegjshme inovacioni dhe projekte të gjeneruara nga universitetet frankofone përmes studentëve, mësuesve, studiuesve dhe stafit.

Për më tepër informacion rreth projektit klikoni në linkun e mëposhtëm:

[Appel à candidature, 2ème édition : Label francophone de l'innovation responsable - AUF](#)